



PSH.nr.916/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar , z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Antarë , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “KCS Trade L.L.C” & “TPK Orometal”- Graçanicë , kundër vendimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi OE: N.T.N“B & D Engineering & Novamat SH.P.K & Karl Wilhelm GmbH-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve të nxehtësisë 2 dhe 3 ” me nr. të prokurimit: KEK-20-776-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Korporata Energjetike e Kosovës”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I.APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “KCS Trade L.L.C” & “TPK Orometal”- Graçanicë , kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve të nxehtësisë 2 dhe 3” me nr. të prokurimit: KEK-20-776-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Korporata Energjetike e Kosovës”,

**II. VERTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve të nxehtësisë 2 dhe 3” me nr. të prokurimit: KEK-20-776-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Korporata Energjetike e Kosovës”.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “KCS Trade L.L.C” & “TPK Orometal”- Graçanicë , i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “KCS Trade L.L.C” & “TPK Orometal”- Graçanicë , si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 05.11.2020 me nr. 916/20, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve të nxehtësisë 2 dhe 3” me nr. të prokurimit: KEK-20-776-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Korporata Energjetike e Kosovës”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 27.4 , 59 , 59.4 , si dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 41.11 , 40.13 të RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 24.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Përgjigje në Pretendimin nr. 1 :** Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka refuzuar ofertën tone kundërligjshëm dhe pas asnjë baze ligjore për mos përmbushjen e kërkesës ne Nenin 9.1 & 9.2, te FDT qe ka te beje me “Autorizim nga prodhuesi i pajisjeve ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni” edhe pse ne për këtë pike kemi ofruar si dëshmi “Autorizimi (Deklarata) e prodhuesit te pajisjeve te kërkuara “TOK OROMETAL” i cili prodhues është pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit si anëtar i konzorciumit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Operatori ekonomik ankues ne ofertën e tij lidhur me kërkesën e dosjes se tenderit



dhe njoftimit për kontratë për ofrimin e Autorizimit të prodhuesit për shitjen e produkteve që ofroni, ka dorëzuar një Deklaratë të prodhuesit "TPK OROMETAL" nga shteti i Kroacisë i cili prodhues është edhe anëtar i konzorciumit të operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit. Pra vet prodhuesi ka bashkangjitur me ofertë deklaratën për këtë aktivitet të prokurimit me të cilin deklaron se produktet e kërkuara do të prodhohen në fabrikën të sipas konfirmimit të CE. Pra ky dokument për mendimin e ekspertit shqyrtues e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit (si kriter i përzgjedhjes) sepse vetë prodhuesi merr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Ky prodhues është nga vendet e bashkimit evropian dhe prodhon produkte me certifikatë të konformitetit CE të cilat standarde prodhimi lejohen për përdorim në shtete të BE-së e më tej. Përshkrimi i dhënë në dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues që është marrë si bazë për eliminimin e OE ankues i cili thotë: "OE duhet të prodhojë tufën e gypave të NTU3 dhe të NTU2, me të gjitha pjesët (flanshën, gypat, përforcuesit, ndarjet etj. plotësisht sipas dizajnit të vjetër. Prandaj OE duhet gjithsesi të ketë në përbërjen e vetë prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguese të pronësisë intelektuale të CASS – prodhuesit të këmbjesit NTU". Për mendimin e ekspertit shqyrtues është çështje të cilën zgjidhjen teknike duhet ta bëjë vetë prodhuesi dhe për këtë OE ankues ka ofruar edhe deklaratën e specifikimeve teknike që produktet ofrohen sipas specifikimit teknike të kërkuar nga AK. Pra nuk mundet të jete bazë për eliminim kjo çështje kur zgjidhjet teknike tani janë të mundshme nga më të ndryshmet. Prodhuesi CASS i këmbjesit të nxehtësisë të cilit janë të montuar tani në KEK, ka mbyllur veprimtarinë. Zgjidhjet teknike tani janë të mundshme për zëvendësimin e produkteve të vjetra të cilat i ka KEK. Është e pa kuptimtë që produktet e një prodhuesi nga vendet e bashkimit evropianë të jenë të pa pranueshme për vendin të tyre. Mbi këtë bazë eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të bazuar.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues :** Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe ka eliminuar OE ankues si tenderues i pa përgjegjshëm për mungesë të autorizimit të prodhuesit edhe pse OE ankues ka aplikuar me një prodhues i cili vjen nga shtetet e bashkimit evropian dhe i njëjti ka ofruar dëshminë për plotësimin e kërkesës së DT-së. Pra nga AK nuk janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së. Është rekomanduar për kontratë OE i cili ka dhënë ofertën me çmim më të lartë mbi 204.000,00 € se oferta e OE ankues. Pra nga kjo rezulton se nuk është respektuar edhe kriteri i dhënies së kontratës, respektivisht neni 60 i LPP-së. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pikë 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit "Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbjesve të nxehtësisë 2 dhe 3 " me nr. të prok. KEK-20-776-511 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 24.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues si me poshtë:

**From:** Ymer Dragusha <Ymer.Dragusha@kek-energy.com>

**Sent:** 30/Nov/20 15:59

**To:** OSHP <oshp@rks-gov.net>

**Cc:** Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>; Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>; Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>; Minator Ferizi <Minator.Ferizi@kek-energy.com>; Villaznim Emerllahu <Villaznim.Emerllahu@kek-energy.com>

**Subject:** FW: 916/20ekspertiza

Te nderuar ,

Autoriteti kontraktues / komisioni i vlerësimit **NUK PAJTOHET** me raportin e ekspertit shqyrtues te anekse nr. 916/20.

Te bashkangjitur ju dërgoj përgjigjen e komisionit te rivlerësimit për mos pajtim me raportin e ekspertit shqyrtues te ankesës nr. 916/20

Ju përshëndes ,

Përgjigjja nga komisioni i ri-vlerësimit lidhur me Raportin e Ekspertit Shqyrtues me numër 916/20 te datës 24.11.2020

Ne shqyrtuam raportin e ekspertit shqyrtues dhe kriteret e përcaktuara nga AK, ku sipas saj ne si komision i ri-vlerësimit qëndrojmë prapa raportit dhe vlerësimit qe kemi bërë me herët dhe se ky raport i ekspertit është i mangët.

Mendimi i ekspertit te OSHP-së është i pa bazuar dhe jo mirë i informuar, këtë e themi duke u bazuar ne pretendimet e tij lidhur me mbylljen e veprimtarisë se Prodhuesit CASS, ku sipas eksperti shqyrtues, prodhuesi CASS ka mbyllur veprimtarinë, me çka kjo nuk qëndrën, sepse Prodhuesi CASS nuk ka mbyllur veprimtarin por ne vitin 2006 është transformuar ne kompaninë C&E Consulting &Engineering Hammoor. Në faqe 27 te OE te propozuar për kontrate është prezantuar një Certifikatë ku thotë se prodhuesi Consulting & Engineering është pasardhës i WECAM GmbH dhe CASS INTERNATIONAL GmbH, i cili konfirmon se ka marrëveshje ekskluzive me Karl Wilhem shpk për përdorimin e dokumenteve origjinale të prodhimit të CASS INTERNATIONAL GmbH. Kjo marrëveshje ekziston qe nga 30 maji 2006. Anëtarët e konzorciumit Karl Wilhelm dhe Novamat e autorizojnë OE B & D qe të veproi në emër të grupit.

Dokument e prezantuar nga OE i propozuar për kontrate ne dokumentet e tij ka paraqitur referenca të ndryshme të prodhuesit Karl Wilhelm. Me këtë liste të referencave dëshmohet se prodhuesi Karl Wilhelm ka prodhuar pajisje të ndryshme siç janë kondenzatori, këmbyes të nxehtësisë se presionit të ulët dhe të lartë me fuqi përkatëse. Këtij dokumentacioni të listës se referencave i bashkëngjitet dokumentacion mbështetës në lidhje me programin e kualitetit të kontrollit (inspektimet dhe testet e bëra), standardet e aplikuara, direktiva e pajisjeve nën presion 2014/68/EU, dokumentet e trupës mbikëqyrëse TUV SGS SAAR, me çka pretendimi i ekspertit shqyrtues nuk qëndrojnë dhe janë te pa bazuar.



Sipas ekspertit shqyrtues OE ankues ka ofruar një prodhues alternative, nga vendet e BE-së dhe ka ofruar dëshmi të kërkuara sipas DT, ku ne si komisionin vlerësojmë prodhuesin që ka paraqitur OE ankues, por duhet të kemi parasysh se prodhuesi origjinal i këtyre këmbyesve CASS, dizajnimin e këmbyesve e ka bërë në koordinim të plotë me projektuesit e turbinës - rrjedhjes së avullit nëpër turbinë (të gjitha shkallët) dhe të rrjedhjes së kondenzatit nëpër sistemin e kondenzatit dhe projektuesit të këtyre këmbyesve që janë objekt i këtij aktiviteti. Pra firma CASS ka qenë prodhues i këmbyesve si tërësi dhe ka qenë në koordinim me prodhuesin e atëhershëm të bllokut MAN&Alstom dhe Stein Industrie, me çka prodhuesi TPK OROMETAL nuk e ka bërë këtë, pasi që këta këmbyes nuk mund të ndërrohen, siç ka kërkuar edhe AK, si tersi, por vetëm tufa e gypave dhe për këtë duhet të ketë autorizim nga prodhuesi origjinal ose dileri i autorizuar.

Këto marrje të avullit ku do të instalohen këta këmbyes nuk janë çdo herë të njëjta, por janë variable, te ndryshueshme, pra nuk janë vlera të caktuara, por ato varen nga bilanci termik i bllokut dhe fuqia termike e kompletë sistemit. Varësisht nga parametrat e kondenzatit, si marrës i nxehtësisë dhe nga parametrat e avullit që kalon nëpër shkallët përkatëse të turbinës së presionit të mesme (pas shkallës 22 të TM, ku ndodhet marrja E3) dhe pas shkallës 24, ku ndodhet marrja E2, zhvillohet këmbimi i nxehtësisë.

Sipas gjithë kësaj ne si komision kërkojmë që OSHP dhe eksperti shqyrtues të shqyrtojnë të gjithë dokumentacionin e ofruar nga OE ankues dhe duhet të bazohen në rendësin dhe specifikimin e këtyre këmbyesve si pajisje special dhe të veçanta që ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e prodhimit të energjisë dhe kapacitete e saj.

Edhe një here ju njoftojmë se OE ankues është eliminuar, sepse nuk ka paraqitur apo dëshmuar Autorizimin nga Prodhuesi Origjinal CASS apo nga dileri i autorizuar i pajisjeve, të kërkuar sipas FTD pika 9.1&9.2 të pjesës së kapaciteteve profesionale në piken 2. Autorizim nga prodhuesi i pajisjeve ose dileri i autorizuar, për shitjen e produkteve që ofron. Kurse në Aneks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME pika 4. Vëllimi i punëve dhe liferimeve, tregon Prodhuesin origjinal të pajisjes. Prandaj OE duhet gjithsesi të ketë në përbërjen e vetë prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguuese të pronësisë intelektuale të CASS – prodhuesit të këmbyesit NTU e kërkuar sipas FTD pika 9.1&9.2.

Po ashtu si vërejtje për OE ankues që Eksperti Shqyrtues nuk e ka pas parasysh është edhe vlefshmëria e sigurimit të tenderit ku sipas FDT pika 13.2 është kërkuar vlefshmëria e sigurimit të tenderit 150 ditë nga data e hapjes së tenderit (18.05.2020) ndërsa OE në sigurimin e dosjes së tenderit e ka të ofruar nga data 12.05.2020, që i bije që nuk e arrin 150 dite të kërkuar sipas FDT.

Me respekt,  
Komisioni i ri-vlerësimit

Me datë:  
26.11.2020

**From:** Ymer Dragusha <Ymer.Dragusha@kek-energy.com>

**Sent:** 04/Dec/20 16:00

**To:** OSHP <oshp@rks-gov.net>

**Cc:** Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>; Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>; Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>; Villaznim Emerllahu <Villaznim.Emerllahu@kek-energy.com>; Minator Ferizi <Minator.Ferizi@kek-energy.com>; Arben Avdiu <Arben.Avdiu@kek-energy.com>

**Subject:** FW: 916/20ekspertiza

Te nderuar

Pa paragjykuar vendimin qe do te merr PSH ne lidhje me ankesën nr. 916/20 , ju lutemi qe mundësisht te trajtoni dhe te merrni vendimin ne një afate sa me te shpejte te mundur dhe pasyaj ne si AK te marrim veprimet e duhura për këtë aktivitet te prokurimit ,

Me qe ky projekt është me rendësi te veçante dhe ne vijim ju dërgojmë email-in e pranuar nga njësia kërkues TC-Kosova B .

Ju pershendes,

**From:** Arben Avdiu <Arben.Avdiu@kek-energy.com>

**Sent:** Friday, December 4, 2020 11:35 AM

**To:** Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>; Emine Gllareva <Emine.Gllareva@kek-energy.com>; Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>

**Cc:** Isak Kerolli <Isak.Kerolli@kek-energy.com>; Jonuz Saraci <Jonuz.Saraci@kek-energy.com>; Abedin Kabashi <Abedin.Kabashi@kek-energy.com>; Skender Isufi <Skender.Isufi@kek-energy.com>; Agron Binakaj <Agron.Binakaj@kek-energy.com>; Behar Qunaku <Behar.Qunaku@kek-energy.com>

**Subject:** Projektet e TCB/ statusi

Te nderuar,

Siç edhe jeni te informuar, TC "Kosova B" është ne fazën final te përgatitjeve te programit te projekteve vetanake te planifikuara qe do të implementohen ne periudhën Mars – Tetor 2021, gjatë kohës se implementimit te DeNOx dhe Elektrofiltra.

Në mesin e këtyre projekteve shume te rëndësishme janë edhe projektet ne vijim:

- Liferimi, demontimi, montimi dhe komisionimi i këmbyesve te nxehtësi 2 dhe 3 (NTU2/3) B1&B2, arritja e fuqisë nominale ne gjeneratorë.

Te nderuar, javën e kaluar ne si përfitues te projektit te DeNOx dhe Elektrofiltra, para BE-së dhe kontraktorit, e kemi pasur obligim që ne detale ta prezantojmë programin e punëve dhe projekteve tona vetanake, qe do te implementohen ne këtë kohe. Këtë program e kemi zyrtarizuar, ku ne mesin e tyre janë te deklaruar edhe projektet e cekura me lartë. Dy nga projektet e sipërme janë pjese e ciklit uji-avull te cilat ndikojnë në efikasitetin e njësive dhe produksionin e avullit. Pa implementimin e këtyre projekteve nuk mund te arrihet performanca dhe fuqia nominale ne gjeneratorë. Fuqia nominale është bazë për tu bërë testet e performancës se projektit te DeNOx dhe Elektrofiltra, ku KEK është zotuar se pas implementimit te projekteve te veta do ta arrij pa asnjë problem fuqinë nominale. Te gjitha këto konfirmime janë te nënshkruara nga menaxhementi i larte i KEK-ut.

Prandaj edhe një here kërkoj nga ju dhe gjithë akterët qe mund te ndikojnë, ne shpejtimin e arritjes se kontratave te cilat gjenden ne procese Ankimore apo ne ZEP, për projektet e cekura me larte, ne mënyrë që mos te humbim kohë. Këtë e themi duke u bazuar edhe ne kohen e gjatë te prodhimit, liferimit dhe montimit te këtyre aseteve qe tash me ne i kemi filluar dhe deklaruar dhe duhet te arrihen ne kohen e përcaktuar.

Sipas informatave qe ne i kemi, nëse KEK-u nuk arrin fuqinë nominale ne Gjeneratorë Elektrike atëherë zyra e BE-së (autoriteti kontraktues i projektit te DeNOx dhe Elektrofiltra), mund ta liroj nga obligimet kontraktorin nga testimi i performancës si rezultat i mos arritjes se fuqisë nominale, ku edhe KEK-un mund ta presin penalizime.

**Ju lutem për mirëkuptim dhe përkrahje.**

Me respekt:

Arben H. Avdiu



Operatorët Ekonomik: "KCS Trade L.L.C" & "TPK Orometal"- Graçanicë, nuk kanë kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre pajisjeve në prodhimin e energjisë elektrike, AK ka specifikuar se është me se e domosdoshme marrëdhënia kontraktuale e çfarëdo prodhuesi me prodhuesin origjinal të këtyre pajisjeve. Këtë e ka specifikuar në specifikimin teknik të detyrueshëm, me saktësisht faqe 23, 4. Vëllimi i punëve dhe liferimeve *"OE duhet të prodhojë tufën e gypave të NTU3 dhe të NTU2, me të gjitha pjesët (flanshën, gypat, përforcuesit, ndarjet etj. plotësisht sipas dizajnit të vjetër. Prandaj OE duhet gjithsesi të ketë në përbërjen e vetë prodhuesin origjinal, ose firmën trashëguese të pronësisë intelektuale të CASS – prodhuesit të këmbjesit NTU."* Gjithashtu kjo çështje është trajtuar edhe nga pyetje sqaruese të DT, në të cilën AK sqaron domosdoshmërinë që OE të ketë marrëveshje me prodhuesin origjinal për arsyet si në vijim: *Shqetësimin e ofertuesit potencial e kuptojmë se në një formë edhe është disi i kufizuar në gjetjen e një prodhuesi për këtë aktivitet, por duke marrë parasysh se në kemi kërkuar vetëm tufën e gypave (një pjesë të këmbjesit të nxehtësisë, jo këmbjesin si tersi), atëherë patjetër duhet që prodhuesi origjinal (ose kompania trashëguese) të jetë si pjesë e këtij aktiviteti-sidomos në sigurimin e vizatimeve të nevojshme teknike, sepse mendojmë që vizatimet të cilat i kemi nuk janë të mjaftueshme për kriteret teknike dhe prodhimin e tufës së gypave.*

*Nëse ne si TCB-KEK do të kërkonim prodhimin e nxemsa të ri (NTU2 dhe 3), atëherë pajtohem me kërkesën e ofertuesit potencial.*

OE ankues në ofertën e tij nuk ka dëshmuar se në ofertën posedon marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin origjinal të pajisjeve. Domosdoshmëria e marrëveshjeve të tilla sipas sqarimeve dhe kërkesave të DT është për shkak të drejtave autoriale sepse AK nuk ka kërkuar të bëhet komplet ndërrimi i këtyre pajisjeve (pra nuk

ka kërkuar pajisje te re) por vetëm ndërrim te një pjese e tyre dhe ne pamundësi te posedimit te dokumentacionit te prodhuesit, atëherë për riparim apo ndërrim te suksesshëm ne mënyrë qe te mos këtë problem me prodhim te energjisë dhe rëndësisë se veçantë te këtyre pajisje është konsideruar se marrëveshja me prodhuesin origjinal te prodhuesit te këtyre pajisjeve sipas DT dhe specifikimit teknik te detyrueshëm.

Kërkesë tjetër e njoftimit per kontrate dhe e dosjes se tenderit, te cilën nuk e ka plotësuar Operatori ankues është edhe vlefshmëria e sigurimit te tenderit ku Sipas FDT pika 13.2 është kërkuar vlefshmëria e sigurimit te tenderit 150 ditë nga data e hapjes se tenderit (18.05.2020) ndërsa OE ne sigurimin e dosjes se tenderit e ka te ofruar nga data 12.05.2020, që i bije qe nuk e arrin 150 dite te kërkuar sipas FDT. E qe është ne kundërshtim me nenin 65 te LPP-se si dhe te RrUOPP-së neni 29.6 ku thuhet: 29.6 Sigurimi i tenderit do te qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Gjithashtu edhe tek *shembujt e mëposhtëm nuk janë te vetmet raste. Varesisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se:*

Problemi	Si te Veprohet?	Neni i LPP-se
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtutjeshëm	57

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie te kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.



Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - "Korporata Energjetike e Kosovës",
- 1x1 OE – "KCS Trade L.L.C" & "TPK Orometal"- Graçanicë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.